



ShKÇAK
DKRRK
SCAAK

Ekspert Tatimor
dhe
Ekspert Tatimor i Larte

1.1. Kërkesat për ta fituar thirrjen 'Ekspert Tatimor' dhe 'Ekspert Tatimor i Lartë'

- *Edukimi universitar*: kandidatët duhet të kenë të kryer së paku një fakultet të nivelit baqelor.

- *Edukimi profesional*: për nivelin e parë 'Ekspert Tatimor' kandidatët duhet të ketë ndjekur trajnimin profesional dhe duhet të kenë kryer të gjitha provimet e parapara. Për nivelin e dytë 'Ekspert Tatimor i Lartë' kandidatët duhet të kenë kryer provimet apo përfunduar ligjëratat e nivelit të parë, si dhe duhet të kenë ndjekur trajnimin profesional dhe provimet e parapara të nivelit të dytë.

- *Përvoja praktike*: kandidatët duhet të kenë së paku 12 muaj eksperiencë në kontabilitet, tatime apo auditim për të fituar thirrjen 'Ekspert Tatimor' dhe së paku 24 muaj eksperiencë për të fituar thirrjen 'Ekspert Tatimor i Lartë'. Përvoja praktike mund të realizohet para ose pas regjistrimit në programin certifikues por thirrja mund të fitohet vetëm pas realizimit të të gjitha kërkesave të programi certifikues.

- *Kodi i etikës*: kandidatët duhet të respektojnë kërkesat e Kodit të Etikës të FNK-së.

1.2. Kërkesat për edukim të vazhdueshëm profesional (EVP)

Pas marrjes së thirrjes 'Ekspert Tatimor' dhe 'Ekspert Tatimor i Lartë' kandidatët të cilët vazhdojnë ta ushtrojnë profesionin e ekspertit tatimor duhet të dëshmojnë kryerjen e 24 orëve të verifikueshme të edukimit të vazhdueshëm çdo vit në mënyrë që ta mirëmbajnë thirrjen e fituar.

EVP-të mund të mbahen në shoqatat profesionale të cilat janë anëtare të FNK-së, apo në shoqatat/organizatat të cilat janë të autorizuara në atë shtet të ofrojnë EVP. Kandidatët duhet të sjellin certifikatën e pjesëmarrjes për secilën orë të EVP-së të cilën e kanë mbajtur.

1.3. Edukimi profesional dhe provimet

Një nga parakushtet për tu certifikuar është edhe ndjekja e edukimit profesional si dhe kalimi i provimeve të listuara në vijim.

Lëndët e parapara për këtë program certifikues janë:

Niveli	Lëndët
I. Ekspert Tatimor	T1: Bazat e kontabilitetit dhe raportimi financiar T2: Ligjet dhe tatimet në Kosovë T3: Analiza e pasqyrave financiare
II. Ekspert i Lartë Tatimor	T4: Raportimi Financiar i Grupeve (Konsolidimet) T5: Tatimet në BE

Anëtarët ekzistues të Shoqatës të cilët e kanë titullin KÇ ose AÇ do të fitojnë titullin si Ekspert i Lartë Tatimor pas përfundimit të provimit T5.

*Si parakusht për t'iu nënshtruar provimit është pjesëmarrja në ligjërata.

**Kalueshmëria e provimit është 50 pikë e lartë.

1.7. Fitimi i titullit “Ekspert Tatimor/Ekspert Tatimor i Lartë” nga anëtarët në

ShKÇAK

Anëtarët ekzistues të Shoqatës mund të fitojnë titullin duke plotësuar këto kushte :

-Teknik Kontabiliteti – do të fitojnë titullin ‘Ekspert Tatimor’ pasi të dëgjojnë ligjëratat dhe kalojnë provimin në lëndën “P5- Raportimi Financiar”.

-Kontabilist i Çertifikuar dhe Auditor i Çertifikuar - do të fitojnë titullin ‘Ekspert Tatimor’.

-Auditor i Brendshëm i Çertifikuar - Lirohen vetëm nga lënda T1.

-Auditor i Çertifikuar i Sektorit Publik - do të fitojnë titullin ‘Ekspert Tatimor’ pasi të dëgjojnë ligjëratat dhe kalojnë provimin në lëndën “P5- Raportimi Financiar”.

* Për të fituar titullin ‘Ekspert Tatimor i Lartë’ anëtarët duhet ti kryejnë obligimet e këtij niveli në përputhje me kërkesat e shpjeguara në këtë dokument.